

VENDIM
Nr. 254, datë 14.10.2025

MBI ZGJATJEN E VENDIMMARRJES SË BORDIT TË ERE-s, LIDHUR ME SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË SHOQËRISË “INFOTELECOM-ALBSOLAR 4” SHPK PËR LICENCIM NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; nenit 14, pika 3, të rregullores “Për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe nenit 15 të rregullores “Për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 14.10.2025, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 2207/11 prot., datë 9.10.2025, të Drejtorisë së Licencimit dhe Autorizimeve “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘Infotelecom-Albsolar 4’ sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike”,

konstatoi se:

- Për qëllime të shqyrtimit të këtij aplikimi janë ndjekur procedurat dhe është analizuar dokumentacioni si vijon:

Paraqitja e kërkesës për licencim

- Shoqëria “Infotelecom-Albsolar 4” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 2207 prot., datë 30.7.2025, ka paraqitur kërkesën e saj për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltai, me kapacitet 35.6 mw me vendndodhje në rrugën “Gjorica e Poshtme”, Njësia Administrative Gjoricë, Bashkia Bulqizë, qarku Dibër.

Fillimi i procedurës së licencimit

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 191, datë 12.8.2025, vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë në këtë veprimtari.

- ERE botoi njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure (në datat 13.8.2025 dhe 14.8.2025) dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve, apo objeksioneve nga të tretët (data 11.9.2025), nuk rezultoi të ketë të tilla. Njoftimi për fillimin e procedurës u botua në rrjetet sociale të institucionit edhe në faqen zyrtare të internetit të ERE-s.

- ERE, po ashtu, ka njoftuar Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) për fillimin e kësaj procedure, nëpërmjet shkresës nr. 2207/4 prot., datë 14.8.2025, ku i ka kërkuar të bëjë me dije nëse nga ana e saj ka një qëndrim ndryshe, në lidhje me vlefshmërinë e kontratës dhe të drejtën e shoqërisë për ndërtimin dhe shfrytëzimin e këtij burimi gjenerues. Nga ana e MIE-s nuk ka pasur kthim përgjigjeje.

Kërkesa për dokumentacionin plotësues

- Me shkresën nr. 2207/3 prot., datë 14.8.2025, ERE ka njoftuar shoqërinë për vendimin e fillimit të procedurës dhe i ka kërkuar depozitimin e informacionit/dokumentacionit të aplikimit të konstatuar të paplotësuar ose të plotësuar pjesërisht.

Vlerësimi i dokumentacionit dhe kërkesa për seancë dëgjimore

- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 2207/5 prot., datë 9.9.2025, shoqëria ka depozituar një pjesë të informacionit/dokumentacionit plotësues, nga shqyrtimi i të cilit është parë e nevojshme zhvillimi i një seance dëgjimore për të sqaruar këtë informacion/dokumentacion, ndaj me shkresën nr. 2207/7 prot., datë 17.9.2025, ERE i është drejtuar shoqërisë duke i njoftuar zhvillimin e kësaj seance dhe plotësimin e dokumentacionit përkatës.

- Pas diskutimeve të zhvilluara në seancën e mbajtur në datën 22.9.2025, përfaqësuesit e shoqërisë morën angazhimin për të plotësuar në vijim informacionin/dokumentacionin e munguar.

- Me e-mail-in e protokolluar në ERE me nr. 2207/8 prot., datë 24.9.2025, shoqëria i është drejtuar MIE-s, duke vënë në dijeni ERE-n, në lidhje me marrjen e një konfirmimi zyrtar, apo një shkresë formale mbi nënshkrimin e Marrëveshjes Përfundimtare dhe Marrëveshjes së Mbështetjes nga MIE. Duke qenë se ky e-mail nuk ishte shterues për sa kërkuar dhe nga sa marrë angazhim nga shoqëria gjatë seancës dëgjimore, ERE i është drejtuar me e-mail-in me nr. 2207/9 prot., datë 1.10.2025, duke i bërë me dije shoqërisë sa më sipër, si dhe duke i rikujtuar detyrimin për depozitimin e dokumentacionit.

- Së fundmi, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 2207/10 prot., datë 1.10.2025, shoqëria ka depozituar një pjesë të dokumentacionit, nga analizimi i të cilit rezulton se ka ende nevojë për t'u plotësuar/saktësuar sa vijon:

- dokumentacioni për mbështetjen financiare për 20% të vlerës së projektit;
- marrëveshja përfundimtare për zhvillimin e projektit;
- njësitë gjeneruese të centralit dhe kapaciteti i instaluar i secilës;
- kapaciteti i instaluar i referuar në VNM-në paraprake.

Zgjatja e afatit të vendimmarrjes

- Referuar nenit 14, pikës 3 të rregullores, parashikohet, se Bordi mund të vendosë rast pas rasti për zgjatjen e afatit për marrjen e vendimit përfundimtar për pranimin ose për refuzimin e aplikimit për licencë kur dokumentacioni nuk është i plotë, por jo më shumë se 30 ditë.

- Për gjithë sa më sipër, me qëllim për t'i dhënë mundësinë shoqërisë për të plotësuar dokumentacionin e munguar të këtij aplikimi, vlerësojmë të zgjatet deri në 30 (tridhjetë) ditë afati i vendimmarrjes së Bordit të ERE-s për aplikimin e shoqërisë për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaiik, me kapacitet 35.6 mw, me vendndodhje në rrugën “Gjorica e Poshtme”, Njësia Administrative Gjoricë, Bashkia Bulqizë, qarku Dibër.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të zgjasë me 30 (tridhjetë) ditë afatin e vendimmarrjes së Bordit të ERE-s mbi kërkesën e shoqërisë “Infotelecom-Albsolar 4” sh.p.k., për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaiik, me kapacitet 35.6 mw, me vendndodhje në rrugën “Gjorica e Poshtme”, Njësia Administrative Gjoricë, Bashkia Bulqizë, qarku Dibër.

2. Shoqëria duhet të depozitojë dokumentacionin e munguar brenda 20 (njëzet ditëve).

3. Drejtoria e Licencimit dhe Autorizimeve të njoftojë shoqërinë për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti